

01-1796



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimit të Kryetarit të Komunës 14nr.350/05-69714/18 dt.22.03.2018, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02 - 181366/20 dt.06.10.2020, të kërkuarit: Pronarit, Sami Qyqalla, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste, me 2B+S+P+7, në kuadër të Blloku “A10” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 28.07.2023, merr këtë:

V E N D I M
CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuarit: Pronarit, Sami Qyqalla nga Prishtina, sipas kërkesës 05nr.350/02 – 181366/20 dt.06.10.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste, me 2B+S+P+7, në kuadër të Bllokut urban “A10”, të Planit Rregullues “Mati 1”, konkretisht parcelës kadastrale nr.761-9 ZK Matiçan, si dhe të trajtuar përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan, me pronar/posedues Komuna e Prishtinës, me pjesën e parcelës kadastrale nr.49-3 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla, sipas dokumentacionit ndërtimor / projektit konceptual dhe zgjidhjes urbane të prezantuar.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të:

a) *Planit Rregullues “Mati 1”, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 nr. 35 - 18186 dt. 03.08.2005, Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues të lagjes “Mati 1” i miratuar me 01 nr. 35-642 dt. 01.04.2010, si dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës me 01 nr. 031-1678 dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani ku sipas këtij plani ky lokacion përfshihet në ngastrën e ndërtimit “F”, tipi MI, dhe*

b) *Planit Zhvillimor Urban, i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 nr.031-181427 dt.24.09.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë ka destinim “Ndërtim i lartë”;*

Pronari për kriteret, parametrat urban si dhe kushtet e ndërtimit, është informuar përmes sistemit shkresës “Informatë nga Plani Rregullues “Mati 1” – PZHU” 04nr.350/01– 689557/20 dt.18.05.2020, lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelave kadastrale nr.761-9, 758-2 & 49-3, sipas gjendjes kadastrale, pronësore, faktike dhe planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronarët & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- nr.761-9; S=541m²; me pronar Sami Qyqalla,.....“Arë e klasës 5”;
- nr. 758-2; S=65m², me pronar Komuna e Prishtinës..... “Arë e klasës 4”;
- **Totali i parcelave të trajtuar: S=606m².**

- Pjesë e parcelës nr.49-3 ZK Matiçan; me $S=65m^2$, me pronar Sami Qyqalla, përfshihet në kuadër të hapësirës publike të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në rrugë & gjelbërim si dhe një pjesë në ndërtim;
- Të drejtat pronësore-juridike për parcelat kadastrale nr.761-9 dhe 49-3 ZK Matiçan janë private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale, kurse parcela kadastrale nr. 758-2 ZK Matiçan është pronë e Komunës së Prishtinës;
- Në kuadër të parcelave kadastrale, sipas incizimit gjeodezik, të punuar nga gjeodeti Faton Bajselmani, me licensë nr. 125, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Janë toka urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni i lokacionit ka pjerrtësi nga drejtimi verilindje kah – jugperëndim, me disnivel $H=3.0m'$;
- Qasja ekzistuese në parcelat kadastrale është përmes rrugës ekzistuese "Abdurrahim Buza", e cila lidhet me rrugën "Ndue Përlleshi" – rrugë e planifikuar sipas Planit Rregullues "Mati 1", gjegjësisht përmes parcelës kadastrale nr.761-15 ZK Matiçan;
- Bazuar në incizimin gjeodezik, të punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group" Sh.p.k e licencuar, me numër të licencës nr.52, për Bllokun urban "A-10" të Planit Rregullues "Mati 1", konstatohet se ky bllok urban është realizuar në masën mbi 50%, sikur që parashihet edhe me nenin 5 të Vendimit të Kryetarit të Komunës, 14nr.350/05-69714/18 dt.22.03.2018;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelave kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa shumë banesore dhe afariste, si dhe ndërtesa të banimit individual.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor dhe rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër "A10", të Planit Rregullues "Mati 1" dhe PZHU në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të dokumenteve të planifikimit hapësinor për realizimin - ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa, me 2B+S+P+7, dhe me hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i Lokacionit – "Situacioni", bashkangjitur këtij vendimi për cakimin e kushteve ndërtimore;
- Me kushtet ndërtimore në kuadër të, të Bllokut urban "A10", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Mati 1" dhe PZHU-së në Prishtinë, planifikohet të ndërtohet kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste – Ndërtesa, me 2B+S+P+7, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste

Ndërtesa - $S=2,620.74m^2$ / $1,938.14m^2$, mbi tokë + $682.60m^2$, nën tokë /, Etazhiteti: 2B+S+P+7;

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesës, konkretisht të përfshira- trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
 - 761- 9, me $S=541m^2$;
 - 758-2, me $S=65m^2$ (pronë e Komunës e trajtuar me këmbim);

Sipërfaqe totale $S=606m^2$.

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesave, konkretisht të përfshira- trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:
 - 761- 9, me $S=0.00m^2$;
 - 758-2, me $S=0.00m^2$ (pronë e Komunës e trajtuar me këmbim);

Sipërfaqe totale $S=0.00m^2$

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale të bashkuara / parcelës ndërtimore (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazën - gabarit të përdheses ose suterrenit, sipas planit rregullues urban lejohet max.60%, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
 $S=541 \times 0.6=324.60m^2$ / sipas PRR-së për pronën private /
 $S=65 \times 0.6=39.00m^2$ / sipas PRR-së për pronën komunale /
 $S=238.76m^2$ / sipas projekt propozimit /
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale të bashkuara / parcelës ndërtimore (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin

II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas kalkulimit dhe projekt propozimit, ISHPN është
S=541 x 0.6=324.60m² / sipas PRR-së për parcelën ndërtimore - pronën private /
S=65 x 0.6=39m² / sipas PRR-së për pjesën e parcelës nr.761-15 me destinim "rrugë" /
S=363.30m² / sipas projekt propozimit konceptual /.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (GSI) është min.10% për tipin e ngastrës "A" dhe 30% për tipin e ngastrës "I", për gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, kjo sipërfaqe është:
S=541 x 0.1=54.10m² / sipas PRR-së për pronën private /
S=65 x 0.1=6.50m² / sipas PRR-së për pronën komunale /
S=184.39m² në tokë dhe 99.3 m² terrace e gjelbër / sipas projekt propozimit konceptual /
- Koeficienti i ndërtimit (TSK) për Blloku Urban "A10" merret sipas Planit Rregullues "Mati 1" për tipin e ngastrave "A"- 3.2. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:
S=541 x 3.2=1731.20m² / sipas PRR-së për pronën private /
S=65 x 3.2=208m² / sipas PRR-së për pronën komunale /
S=1,920.14m² / sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe këmbimin /.
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, për këtë lokacioni, tipi i mbulimit d2, mundëson ndërtimin e ndërtesave me një gjatësi prej maksimum 25m dhe sipërfaqe të lirë prej 0.4H (ku H është lartësia e ndërtesës) ose së paku 3m'.
- Kuota e përdheses së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e nivelit të rrugës publike, nga e cila ka qasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero, por jo më e ulët se kuota e nivelit të rrugës publike dhe ajo është max. 1.2m
- Qasja në parcelë ndërtimore të jetë përmes rrugës ekzistuese "Abdurrahim Buza", gjegjësisht përmes parcelës kadastrale nr.761-15 ZK Matigan;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesëve) të ndërtesës kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit sipas Rregullores MMPH Nr.03/2016 është 1VP/njësi banimore. Për pjesën e afarizmit min. 1 VP për 30m² afarizëm sipërfaqe të shfrytëzueshme. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritit të ndërtesës;
- Kompleksi të organizohet edhe me vendparkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotualet etj;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për grumbullimin e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar, si dhe karakterit dhe kontekstit të zonës;
- Bazuar në nenin III të Vendimit të Kryetarit të komunës së Prishtinës 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, për shkaqe të shfrytëzimit efijent të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Aplikimi i të gjithave kushteve dhe kriterëve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Planit Rregullues "Mati 1" dhe Planit Zhvillimor Urban- PZhU.

V. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale, nr.758-2 & 49-3 ZK Matigan, do të realizohet sipas vijës rregulluese të Planit Rregullues "Mati 1", Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e përcaktuar në manualin e ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar Faton Bajselmani nga Prishtina, me licencë nr.125.

Drejtoria jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar

në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Ndarja të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarit / investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan, me pronar / posedues Komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej S=65m², që shtrihet brenda bllokut për ndërtim, do të realizohet me pjesën e parcelës kadastrale nr.49-3 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla e destinuar me destinim publik- rrugë e planifikuar, sipas Planit Rregullues "Mati 1".

Procedura e Këmbimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve/investitorit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

VII. Bashkimi i parcelës kadastrale nr.761-9 ZK Matiçan me pjesën e parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan me pronësi Komuna e Prishtinës (pas realizimit të këmbimit), do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit — "zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelës dhe pjesëve të lartcekura, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të bëhet pas realizimit të pikës VI të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo Drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në i'rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, nuiiri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi ", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, në këtë përmbajtje:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e loltacionit, të gjerë në diametër prej 50m , me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ



KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiluarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detajet e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujës-jellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizimi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

X. Dokumentacioni ndërtimor për Masat Mbrojtëse nga Zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtim të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m", me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

XI. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XII. Marrëveshja për infrastrukturë — bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të

vlërësorë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

XIII. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE- meqenëse parcela dhe pjesët e parcelave kadastrale të përfshira në këto kushte ndërtimore, në bazë të certifikatave së njësisë kadastrale, janë evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelave "Arë e Klasës 5" dhe "Arë e Klasës 4", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës, të cilës do t'i ndërrohet destinimi i llojit të shfrytëzimit, do të llogaritet në bazë të sipërfaqes që shtrihet brenda vijës rregulluese, gjegjësisht **S=606m²**. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, andaj, kjo Drejtori jep PELQIM për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Kjo pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas realizimit të pikave V dhe VI të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore, bazuar në pëlqimin e dhënë në këtë paragraf.

XIV. PAGESA E TAKSËS administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për Dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës" 01 nr. 434/01—0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokuimentacionin ndërtimor/projektin, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XV. VLEFSHMËRIA E VENDIMIT për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuar: Pronari Sami Qyqalla nga Prishtina, Lagjja "Mati 1" p.n. me kërkesën 05nr.350/02-181366/20 dt.06.10.2020, ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste me 2B+S+P+7, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të këtij vendimi.

Me kërkesën për kushte ndërtimore, si dhe gjatë procedurës së trajtimit, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr.761-9 dhe nr.49-3 ZK Matigan, si dhe kopjet e planit të tyre, të lëshuara nga Drejtorja e Kadastrit;*
- *Projekt propozimi konceptual – "zgjidhja urbane" me projektin ideor, hartuar nga "BB Architects" nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811928003, dhe me projektues ark.Aulona Blakaj;*
- *Vërtetim mbi obligimet tatimore të Sami Qyqalla nr. 10-430/03-0140615/20 dt. 14.08.2020, të lëshuar nga Drejtorja e Financave e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e dokumentit identifikues të Sami Qyqalla;*

- Shkresa "Informim nga Plani Rregullues Mati 1 - PZHU" nr. 04-350/0 1-689557/20 dt. 18.05.2020, të lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës;
- Akti noterial "Deklaratë nën betim" përpiluar te Notere Valbona Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë me LRP.nr.5336/2022 dt.15.12.2022 e dhënë nga mes të Sami Qyqalla, "BTP. Holding"sh.p.k. nga Prishtina dhe "Nura Group"sh.p.k. nga Prishtina;
- Akti noterial "Deklaratë Pëlqimore" përpiluar te Noter Burim Z. Xemajli në Prishtinë me LRP.nr.612/2021 dt.12.02.2021, e dhënë nga Sefer Kokollari dhe Sami Qyqalla;
- Aktin noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët", e lidhur në mes të pronarëve Sami Qyqalla dhe Investitori "BTP Holding" shpk. nga Vushtrria, me numër unik identifikues 810693897, me pronar Sabri Hasani përpiluar te notere Valbona Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë, me Nr. i LRP: 5334/2022, Nr. i REF.:2499/2022, dt. 15.12.2022;
- Inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale – gjendjes faktike, si dhe propozimin për këmbim dhe bashkim të parcelave (kopje fizike dhe digjitale), të punuar nga gjeodeti Faton Bajselmani me licence nr. 125;
- Fotot e lokacionit;
- Procesverbalet e datës 23.03.2022 dhe 28.01.2021 të përpiluar nga zyrtari – bartësi i lëndës në Drejtorinë e Urbanizmit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/02-181366/20 dt.06.10.2020, dokumentacionin e prezantuar me kërkesë dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, aktuale - në fuqi, për atë zonën urbane, në mënyrë kronologjike konstaton se:

Kërkuesi Sami Qyqalla nga Prishtina me kërkesën e lartcekur duke prezantuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe projekt propozimin konceptual për ndërtesën shumë banesore & afariste B+P+4, fillimisht të hartuar nga Kompania "Arcadis"sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK 810883373 me projektues Naim Matoshi, ark.,ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste me B+P+4, duke prezantuar edhe projekt propozimin konceptuale të ndërtesës ;

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës në fazën fillestare të saj dhe zhvillimit të procedurave të lartcekura, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 18.11.2020, në vende të dukshme të lokacionit dhe rrethinës, ka vendosur Afishen "Njoftimi publik" me projekt propozimin konceptual, e cila ka qëndruar gjerë me datë dt.02.12.2020, me të cilën veprim para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës është synuar të informohet me kërkesën e aplikuarve dhe të njëjtëve i është ofruar mundësia për dhënien e komenteve, gjegjësisht pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrimin e dritës prej 50m²;

Pas këtyre konstatimeve dhe analizës së projekt propozimit konceptual në raport me Planin Rregullues "Mati 1", është konstatuar se në pjesën kah rruga e planifikuar, brenda vijës rregulluese të parcelës që trajtohet, përfshihet edhe pjesa e parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan, me pronar / posedues Komuna e Prishtinës, ku sipas Planit Rregullues "Mati 1" edhe kjo parcelë përfshihet në ndërtim, andaj edhe kërkuesi ka propozuar që e njëjta të këmbëhet me pjesën e parcelës kadastrale nr.49-3 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla nga Prishtina, e cila pjesë e parcelës përfshihet në rrugë dhe gjelbërim të planifikuar të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë. Andaj, duke llogaritur këtë pjesë të parcelës (nr.758-2 me S=65m²) dhe parcelën kadastrale nr. 961-9 ZK Matiçan, formohet parcela ndërtimore me S=606m²;

Gjithashtu, bazuar në planin e situacionit – "zgjidhja urbane" e propozuar dhe projekt propozimit konceptual, konstatohet se qasja në ndërtesën e planifikuar në kuadër të parcelës kadastrale nr.761-9 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla nga Prishtina, do të realizohet përmes nivelit të bodrumit – 1B, në bodrumin e ndërtesës gjithashtu -1B, dhe kjo lidhje i ndërlidhë dy ndërtesat, të **Kompleksit "BTP Rezidencë 2"** me ndërtesa shumë banesore & afariste –

Ndërtesa: "A10/01" me 2B+S+P+9, **"A10/02"** me 3B+P+8 dhe **"A10/A"** me 3B+0 (*Aneksi garazhues*), në kuadër të Bllokut urban "A10", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Mati 1" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale: nr. 761-6, 761-7, 761-8, 761-10, 761-15, 761-16 & 761-17 ZK Matiçan, si dhe me trajtim përmes këmbimit të parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan, me pronar/posedues Komuna e Prishtinës me pjesën e parcelës kadastrale nr.621-2 ZK Matiçan, me pronar / posedues Adem, Hetem, Fadil dhe Rustem Berisha nga Prishtina, sipas projekt propozimit konceptual dhe Planit të situacionit - "zgjdhjes urbane", e cila kërkesë për kushte ndërtimore 05nr.350/02 - 20151/23 dt.26.01.2023, është në trajtim e sipër (*në fazën finale të saj*).

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje në rrugën të planifikuara të planit rregullues dhe ndër të tjera konstatohet:

Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Sami Qyqalla, në lagjen Mati 1, në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-181366/20 dt.06.10.2020, kyçja për automjete për ndërtesën A1/03 me etazhitet 2B+S+P+7, në rrugën kyçëse ekzistuese "Abdurrahim Buza" si rrugë e brendshme e bllokut A10, sipas zgjidhjes së prezantuar mund të pranohet si e tillë, marrë parasysh lokacionin e kësaj zgjidhje urbane, dhe inkorporimin e saj në rrugën kyçëse e cila është e aprovuar me zgjidhjet paraprake. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës kyçëse ekzistuese dhe në kohën kur realizohet ajo.

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", si dhe diskercionin për vendosje të çështjeve të planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe në bazë të nenit 21, 22 & 45 të LPPA-së Nr.05/L - 031, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit vendosi që ta miratojë kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore, me faktet – provat e prezantuar, ta trajtojë sipas rregullativës ligjore në fuqi, me ç'rast konstatoi se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe se projekt propozimi me planin e situacionit - "zgjdhja urbane" të prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban "Mati 1" dhe PZHU-së për atë hapësirë, andaj edhe ka caktuar kushtet ndërtimore, në emër të Pronarit, Sami Qyqalla nga Prishtina, sipas kërkesës 05nr.350/02 – 181366/20 dt.06.10.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste, me 2B+S+P+7, në kuadër të Bllokut urban "A10", të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht parcelës kadastrale: nr.761-9 ZK Matiçan, si dhe të trajtuar përmes këmbimi të pjesës së parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan me pronar/posedues Komuna e Prishtinës, me pjesën e parcelës kadastrale nr.49-3 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla, sipas dokumentacionit ndërtimor / projektit konceptual dhe "zgjdhja urbane" të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitivët e vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjdhja urbane" e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste me 2B+S+P+7, në kuadër të Bllokut urban "A10", të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht parcelës kadastrale: nr.761-9 ZK Matiçan, si dhe të trajtuar përmes këmbimi të pjesës së parcelës kadastrale nr.758-2 ZK Matiçan me pronar/posedues Komuna e Prishtinës, me pjesën e parcelës kadastrale nr.49-3 ZK Matiçan, me pronar / posedues Sami Qyqalla, Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga PRRU "Mati 1" në sistemin koordinativ KosovaREF 01 dhe Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale;

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

I dërgohet: Kërkuesve/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05nr.350/02-181366/20 dt.06.10.2020.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 181366/20 DT. 28.07.2023**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini,



Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,



Drejtori:
Arber Sadiki.






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale

Prishtinë: 15.10.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : _____

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan


Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

Propozim për këmbim dhe bashkim të parcelave
00758-2 dhe 00761-9 Z.K.Matiçan

Koordinatat e ndarjes		
Nr	Y	X
1	7514669.614	4723428.669
2	7514666.843	4723425.089
3	7514666.541	4723424.699
4	7514653.705	4723434.544
5	7514655.574	4723436.909



Rilevoi / Snimio: "Geo-Group" Sh.p.k.

(emri dhe mbiemri i gjeodetit kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: _____

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 52

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

V.V.

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



Spisica e parcelës	Tërbijara	Tërfaqësuar
SPN 32	60296 m ² = 32x 7932 m ²	73814 m ²
SP-P 06	60296 m ² = 06 x 36177 m ²	23876 m ²
ESL/01	60296 m ² = 01 x 60296 m ²	18437 m ²
Niveli përfundimtar		16

Projekti:	Faza:	Permbajtja:
Projekt i ideor	Arktektura	Situacioni i gjërë
Elazhlieti:	Niveli:	Perpjesa 1:350
2B+S+P+7	±	Fleta: 04
Lokacioni:	Projektori:	
Prishtinë	Msc.ark. Aurora Blakaj Bsc.ark. Dorina Heqimi cand Bsc.ark. Dorina Heqimi	
Parcelat:	Data:	
00761-9, ZK: Matçan	Qershor, 2023	

BB Architects





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 49-3, 758-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan

Numri i lëndës / Broj predmeta: 219/2021

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel



Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: _____

Lista e koordinatave:

Manuali per kembime te pjeseve te parcelave

Shkalla 1:750

Nr.	Y(m)	X(m)
1	7515207.861	4724122.695
2	7515192.063	4724140.166
3	7515165.880	4724112.832
4	7515187.956	4724090.749
5	7515194.225	4724085.639
6	7515218.380	4724114.161
7	7514892.670	4723273.300
8	7514878.580	4723284.440
9	7514874.853	4723282.111
10	7514871.267	4723276.060
11	7514810.220	4723319.562
12	7514780.126	4723339.640
13	7514751.464	4723359.895
14	7514690.052	4723406.286
15	7514666.843	4723425.089
16	7514669.614	4723428.669
17	7514655.574	4723436.909
18	7514639.704	4723446.509
19	7514629.324	4723430.430
20	7514639.620	4723424.670
21	7514653.192	4723416.795
22	7514655.203	4723415.600
23	7514664.312	4723410.159
24	7514675.652	4723403.399
25	7514680.170	4723400.710
26	7514705.482	4723385.891
27	7514723.270	4723375.520
28	7514741.310	4723364.460
29	7514753.550	4723356.610
30	7514776.330	4723340.720
31	7514792.749	4723329.150
32	7514801.001	4723322.972
33	7514813.268	4723313.540
34	7514825.698	4723303.600
35	7514843.537	4723289.250
36	7514883.126	4723257.221
37	7514919.524	4723227.371
38	7514941.990	4723213.721
39	7514945.270	4723212.400
40	7514906.370	4723245.680
41	7514889.590	4723260.360
42	7514889.820	4723262.370
43	7514890.520	4723270.120
44	7514653.705	4723434.544
45	7514666.535	4723424.705
46	7515217.000	4724112.532
47	7515190.200	4724138.221



Nr.	Parcelat	Siperfaqet per kembim (m²)
1	49-3	65m²
2	758-2	65m²

Rilevoi / Snimio: Faton Bajselmani

(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 125

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 05.10.2021

Regjistri i Fletparaqitjes: _____



Aprovoi / Usvojio: _____

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____